



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 65/1 prot.

Himarë, më 06.01.2023

**NJOFTIM MBI REZULTATET E VERIFIKIMIT PARAPRAK
PËR PRANIM NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL
NË KATEGORINË E ULËT DHE TË MESME DREJTUESE**

**Drejtore drejtorie, në drejtorinë e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës, pyjeve
dhe kullotave**

Në zbatim të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe të kreut III, të vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese", i ndryshuar me VKM nr. 748, datë 19.12.2018,

Drejtoria e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse, në përfundim të verifikimit paraprak të kandidatëve, për përmbushjen e kushteve dhe kërkesave të veçanta të shpallura në shpalljen për konkurrim, njofton se:

Kandidati i kualifikuar për të vazhduar fazën e dytë të vlerësimit për procedurën e pranimit nga jashtë shërbimit civil për pozicionin: *Drejtore drejtorie, në drejtorinë e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës, pyjeve dhe kullotave*, është:

1. Z. Ilia Gjika

- A. Testimi me shkrim do të zhvillohet në datën 19.01.2023 ora 11:00 në ambientet e Bashkisë Himarë.
- B. Intervista e strukturuar me gojë do të zhvillohet në datën 19.01.2023 ora 13:00 në ambientet e Bashkisë Himarë.

BASHKIA HIMARË

Drejtoria e burimeve njerëzore shërbimeve mbështetëse

